



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Nr. _____ Prot, datë _____. 2017



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

Nr. 1635 Prot, datë 28.12.2017

MARRËVESHJE

PËR

BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT

SHKENCOR

NDËRMJET

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

DHE

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, i përfaqësuar nga Rektor Prof. Dr. Arben GJATA, dhe Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë, i përfaqësuar nga Rektor Prof. Roland Zisi, bien dakord të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumëanshëm në funksion të zhvillimit institucional.

Neni 1

Bashkëpunimi ndërmjet dy Universiteteve do të përfshijë:

- a. Shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor;
- b. Shkëmbimin e pedagogëve, të kërkuesve dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore shkencore;
- c. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese;
- d. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
- e. Shkëmbimin e literaturës shkencore;
- f. Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional.



- g. Rritjen e aksesit të stafit akademik me kohë të plotë të Fakultetit të Shëndetit Publik të Universitetit "Ismail Qemali" për zhvillimin e ciklit të tretë të studimeve pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- h. Ngritjen e programeve të përbashkëta të studimit në të gjitha nivelet.

Neni 2

Të dy Universitetet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Për detajimin e bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-f) dhe ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes, realizohet nga i ngarkuari i Rektorit ose Dekanët e Fakulteteve, nga secili Universitet.

Neni 3

Çdo nen i kësaj Marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet të dy Universiteteve.

Neni 4

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy Universitetet janë dakord për këtë. Nëse njëri prej Universiteteve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.

Mosrinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga Universiteti i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi lexohet, firmoset nga Rektorët përkatës.

Për "Universitetin e Mjekësisë, Tiranë"

REKTOR

PROF.DR. ARBEN GJATA



Për Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë

REKTOR

PROF.DR. BOLANDEZISI





DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PRONËSISË INDUSTRIALE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

Nr. 463/Prot.

Nr. Prot. 143111

Tiranë, më 15/12-1 2017

Vlorë, më 15/12 /2017

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

DHE

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

Me qëllim nxitjen e zhvillimit në fushën e shkencës dhe teknologjisë dhe inkurajimit të punës shkencore dhe kërkimore në Shqipëri nëpërmjet:

- Rritjes së ndërgjegjësimit të studentëve, stafit akademik dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore dhe shkencore, për të drejtat që ata gëzojnë mbi punët e tyre;
- Krijimit dhe vënies në dispozicion të tyre të një sistemi efektiv të informacionit për arritjet e mëparshme (shpikjet) në fushat e ndryshme të shkencës;

si dhe;

- Duke parë nevojën për bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe mirëkuptimin dypalësh mes dy institucioneve palë në këtë marrëveshje, në arritjen e objektivit të mësipërm;
- Dëshirën e mirë për krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e hohjeve dypalëshe;
- Mbështetjen për mundësinë e kryerjes së praktikave të studenteve pranë DPPI-së;
- Mbështetjen në parimet e barazisë dhe përfitimit të përbashkët;



Lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi midis palëve:

Drejtoria e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (në vijim **DPPI**), me seli në adresën Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona nr.33, ish Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z. Elvin Lako;

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë me seli në adresën, Lagja Pavarësia, Rr. "Kosova 9400" Vlorë, Shqipëri, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Roland Zisi;

Të cilat, këtu e më poshtë do të njihen si "palët".

DUKE QENË SE:

DPPI është institucioni përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri, midis të cilave dhe të drejtat e shpikësve mbi: Shpikjet dhe Modelet e Përdorimit; Disenjt Industrial, Topografite e Produkteve Gjysëmpërçues; institucioni që krijon, ruan dhe administron bazën e të dhënave për këto objekte të Pronësisë Industriale si dhe institucioni përgjegjës për zhvillimin e politikave për promovimin e këtyre të drejtave;

dhe

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë është institucioni akademik publik, i rëndësishëm në Shqipëri në fushën e studimeve universitare dhe pasuniversitare të profilit shkencor dhe teknologjik, i cili ka në përbërjen e tij katër Fakultete: 1) Fakultetin e Ekonomisë; 2) Fakultetin e Shkencave Teknike; 3) Fakultetin e Shkencave Humane dhe 4) Fakultetin e Shëndetit Publik.

Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi mes palëve për:

- a) Rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve, stafit akademik shkencor, shpikësve dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore e shkencore, lidhur me rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale, si të drejta që u takojnë ekskluzivisht shpikësve dhe që ju sjellin atyre, përveç përfitimit moral, edhe përfitim ekonomik, si rezultat i shfrytëzimit të shpikjeve në industri;



b) Krijimin e infrastrukturës së nevojshme për vënien në dispozicion të studentëve, stafit akademik dhe shpikësve, të informacioneve periodike lidhur me arritjet e mëparshme në fushat e ndryshme të teknologjisë (shpikjet e bëra publike) si dhe të informacionit të nevojshëm lidhur me të drejtat ligjore që gëzojnë shpikësit dhe mënyrat ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Neni 2

Qëllimi

Me qëllim realizimin e objektit të kësaj marrëveshjeje, palët angazhohen në realizimin e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Krijimin e Qendrës së Informacionit Teknik dhe Shkencor pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- b) Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si seminare, konferenca, ekspozita, trajnime të ndryshme që kanë për qëllim ndërgjegjësimin e studentëve, stafit akademik dhe kërkimor-shkencor për rolin që ka mbrojtja e të drejtave mbi shpikjet në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë në vend.
- c) Përgatitjen e materialeve informuese dhe promovuese;
- d) Shkëmbimin e informacionit dhe publikimeve të ndryshme;
- e) Çështje të tjera me interes të përbashkët.

Neni 3

Detajet e Palëve

Në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë marrëveshje:

- a) DPPI merr përsipër të vendosë në dispozicion të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, materialet informuese, specialistët dhe ekspertët që do të ofrojnë seminare apo trajnime për stafin akademik dhe shkencor në fushën e Pronësisë Industriale;
- b) DPPI mer përsipër të vërë në dispozicion bazën e nevojshme materiale për Qendrën e Informacionit Teknik dhe Shkencor, sipas listës në Aneksin I të kësaj marrëveshjeje.
- c) DPPI mer përsipër, me kërkesë të Universitetit dhe bazuar në mundësinë dhe kushtet, rast pas rasti të pranojë realizimin e praktikave të studentëve pranë DPPI-së.
- d) Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë merr përsipër të ofrojë ambientin e përshtatshëm në bibliotekën e tij, ku do të vendoset Qendra e Informacionit Teknik dhe Shkencor, përkatësisht në bibliotekën e Universitetit si dhe stafin e nevojshëm për funksionimin e kësaj Qendre.

Neni 4

Detajet e organizimit e aktiviteteve



Detajet lidhur me realizimin e aktiviteteve të parashikuara nga kjo marrëveshje për palët do të përcaktohen, për çdo rast, me anë të marrëveshjes së përbashkët ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të DPPI-së dhe Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 5

Hyrja në fuqi, ndryshimi dhe mbarimi

- a) Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët dhe është e vlefshme deri sa palët të kërkojnë me shkrim shfuqizimin ose mbarimin e saj.
- b) Asnjë ndryshim nuk mund t'i bëhet marrëveshjes në mënyrë të njëanshme, përveçse me shkrim, si dhe pasi palët të kenë rënë dakord paraprakisht midis tyre dhe të kenë autorizuar ndryshimin nëpërmjet nënshkrimit nga titullarët e palëve.
- c) Shfuqizimi në mënyrë të njëanshme i kësaj marrëveshjeje mund të bëhet në çdo kohë nga secila prej palëve, por duke lajmëruar me shkrim 30 ditë më parë palën tjetër.

Neni 6

Monitorimi i zbatimit

- a) Me qëllim vlerësimin e suksesit në përmbushjen e objektit dhe qëllimit të kësaj marrëveshjeje, DPPI merr përsipër të përgatisë një raport vlerësues çdo vit nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes.
- b) Raporti vlerësues do t'i paraqitet për miratim palës tjetër, pasi ky raport të jetë diskutuar më parë në takimin e përbashkët mes përfaqësuesve të të dyja palëve, që mbledhet për këtë qëllim.

Neni 7

Personat e kontaktit

Palët bien dakord të caktojnë personat e kontaktit për ndjekjen dhe zbatimin e marrëveshjes në mënyrë shkresore, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe sa here që kërkohet zëvendësimi i tyre.

Neni 8

Dispozita finale

- a) Marrëveshja hartohet dhe pranohet nga palët, duke nënkuptuar se asnjë pjesë e saj nuk është në tejkallim ose kundërshtim të dispozitave përkatëse ligjore, mbi të cilat palët mbështesin ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave e tyre.
- b) Palët zotohen të zbatojnë vullnetarisht dhe në kushte mirëbesimi këtë marrëveshje, për sa parashikohet në të. Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila

nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, sipas përcaktimit në nenin 5 (b).

Marrëveshja e bashkëpunimit hartohet në 2 (dy) kopje identike dhe nënshkruhet në Vlorë, më datë _____.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PRONËSISË INDUSTRIALE**

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Z. Elvin LAKO

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE**

REKTORI

Prof. Roland ZISI



ANEKS I

Në zbatim të pikës b, të nenit të marrëveshjes, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale vë në dispozicion të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, për qëllim të krijimit të Qendrës së Informacionit Teknik dhe Shkencor, pajisjet sipas listës së mëposhtëme:

Tipi i Paisjes	Sasia
Desktop (do të vendosen dhe emërtimi dhe serial number)	2
Monitor (do të vendosen dhe emërtimi dhe serial number)	2
UPS (do të vendosen dhe emërtimi dhe serial number)	2
Printer (do të vendosen dhe emërtimi dhe serial number)	1
Stendë promocioni për vendosjen e materialeve promovuese dhe informative (fletëpalosje, libra dhe broshura)	2
Roll up + banner	2

